



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.361/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “PETROL COMPANY” SH.P.K me numër biznesi 70407467, NUI 810527195, i përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve "Vokshi & Lata", me seli ne Rr. B, Hy. C 15/10, nr. 3, Prishtinë, kundër të paditurës AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCES, me seli ne Prishtine, për anulimin e Vendimit Nr. 41/2020 me numër protokolli 165/20-0210 i datës 06.05.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 19.01.2024 dhe me datë 16.04.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Florin Lata avokat, përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur, I.H.B., E.Sh., dhe R.A., më datë 29. 04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit “PETROL COMPANY” SH.P.K me numër biznesi 70407467, NUI 810527195, kundër të paditurës AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCES, me seli ne Prishtine, për anulimin e Vendimit Nr. 41/2020 me numër protokolli 165/20-0210 i datës 06.05.2020, **si e pabazuar.**

- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 04.06.2020, në Gjykatën Themelore të Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative, paditësi "Petrol Company" SH.P.K me Numër Biznesi 70407467, NUI 810527195, i përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve "Vokshi & Lata", me seli ne Rr. B, Hy. C 15/10, nr. 3, Prishtinë, kundër të paditurës Autoriteti Kosovar i Konkurences, me seli ne Prishtine, për anulimin e Vendimit Nr. 41/2020 me numër protokollit 165/20-0210 i datës 06.05.2020. Lënda është evidentuar me shifrën A.nr. 972/2020.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 361/22.
3. Gjykata caktoi dhe mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik me datë 16.04.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit Florin Lata avokat nga Shoqëria e Avokatëve "Vokshi & Lata", sipas autorizimit të datës 01.03.2019, dhe me pjesëmarrje të përfaqësueses të palës se paditur I.H.B., si dhe ekspertit A.L., dhe me datë 19.01.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Florin Lata avokat, dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesve të palës se paditur I.H.B., E.Sh., dhe R.A. sipas autorizimit të datës 13.12.2023.

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se vendimit nr. 41/2020 me numer prot. 165/20-0210 i datës 06.05.2020 është i kundërligjshëm. Më date 31.01.2020, paditesja ka pranuar nga e paditura njoftimin per konstatimin e gjendjes faktike lidhur me procedurën hetimore të filluar me konkluzionin me nr.01/19, me date 13.02.2020 eshe mbajtur seanca dëgjimore, me 06.05.2020, e paditura ka nxjerre vendimin me nr. 41/2020, me te cilin ka konstatuar se paditesia, Petrol Company SH.P.K. ka çregulluar konkurrencën tregtare gjate muajve Nentor dhe Dhjetor te vitit 2018, e që me keto veprime ka kryer shkelje te nenit 4 par:1 ne par. 1 te Ligjit per Mbroitien e Konkurrences "Marrveshje te ndaluar apo praktike e bashkërenduar", dhe te njejtës i është shiptuar masa ndeshkuese administrative ne

shume prej 3.00% te totalit te te hyrave per 6 mujorin e vitit 2018, ne vlere prej € 191,535.22.

5. Ka deklaruar se vendimi është i paligjshem ne kuptim te nenit 52 te Ligjit te Procedures se Pergjithshme Administrative, dispozitivi eshte juridikisht i paqarte dhe ka kunderthenje ndermjet dispozitivit dhe arsytimit. Ne piken 1 te dispozitivit nuk kuptohet se fare çka konstatuar e paditura ku thote se Petrol Company ka çrregulluar konkurrencen tregtare gjate muajve nentor dhe dhjetor të vitit 2018 e qe me këto veprime ka kryer shkelje te dispozitave te Ligjit per Mbrotjen e Konkurrences nr. 03/I-229 neni 4 Marreveshje te ndaluara apo Praktike te bashkerenduar" pasi keto jane dy nocione te ndryshme. Nuk është e qartë se urdhërohet paditësi.
6. Vendimit i mungon arsytimi i kuptueshëm në kuptim të nenit 48 të LPPA-së, vendimi nuk sqaron se mbi bazen e cilave prova ka nxjerr vendimin e atakuar, pasi që askund ne vendim nuk listohet provat e administruara, e paditura nuk i ka administruar e as vlerësuar te gjitha provat me rëndesi, siç parashihet me dispozitat e LPPA-së perkatesisht me nenet 86, 88 dhe 89 dhe as nuk sqaron se cilave prova ju fali besimin.Pretendimet e paditeses te paraqitura permes komenteve te dorezuara me shkrim dhe te paraqitura ne seancen degjimore as nuk janë permendur fare ne vendim, e aq me pak te jetë dhene sgarime pse nuk jane pranuar pretendimet e pales paditëse. Arsytimi pos tjerash është edhe me formulime dhe kalkulime e tabela statistikore qe jane per 14 kompani e nuk eshte arsytim i individualizuar.
7. Pretendimi se paditësja e ka çrregulluar procedurën paraget nje formulim te pergjithshem dhe abstrakt sepse i padituri nuk ka nxjerrë ne konstatim te veçante per paditesin dhe nuk i ka paraqitur faktet vendimtare. Perkunder mungeses se provave te Autoritetit te Konkurrences, megjithatë Paditesja ka paraqitur prova e saj (kupone fiskal etj) qe deshmojne se çmimet e shitjes nuk kane qenë te njejta ne pikat e Petrol Company, dallimi ka qenë deri në 15 cent, rrjedhimisht nuk kane mund te jene identike as me kompanite konkurrenente.
8. Konsideron se Petrol Company nuk ka pasur marrëveshje me konkurentet e saj per caktimin e çmimit te shitjes me pakice, por çmimet e shitjes me pakice kane variuar nga nje pike e shitjes me pakice tek pika tjeter me pakicë. Gjatë dhjetorit 2018

çmimet kanë qene nga 0,99 euro e deri ne 1,24 euro. (çmimi mesatar mujor ne piken Ferizai ka qene 1.06 euro ndersa ne piken e shitjes Pejë-gender ka qene 1.21 euro. Pra dallim ky prej 15 cent ne liter ne mes te pikave te ndryshme te vete paditeses. Rrjedhimisht, me që çmimi bleres ka qene i njejte ndersa çmimi shitjes ka qene i ndryshëm, edhe fitimi bruto/1 ka variuar nga pika ne pike. Edhe per muajin nentor 2018, tek pika e shitjes tek Medreseja ne Prishtine, çmimi mesatar mujor ka qene 1,14 euro. ndersa ne piken e shitjes Peje çmimi mesatar ka qene 1,21 euro, apo ne Arberi çmimi mesatar ka qene 1,19 euro. Me që kemi dallime kaq te mëdha ne çmime brenda pika shiteses te kompanise, atehere per cfare marreveshje apo praktike të bashkerenduar me kompanite konkurrenente ishte duke pretenduar e paditura. Kur mund te thuhet se vete pikat e shitjes se paditises nuk kanë pasur marreveshje apo praktike te bashkerenduar mes vete.

9. Theksohet se ne te tre vitet e fundit fitimi mesatar vjetor per liter i paditises ka qene 0.10. Marzhat e fitimit nga ana e Petrol Company gjate periudhes kontestuese (Nentor Dhjetor 2018) kane qene reflektim i marzhave te ulta te fitimit që kompania ka realizuar në muajit paraprak dhe per kete arsye, ka vendosur qe ne dy muajt e fundit te vitit të realizonte planin e vet ekonomik per te arritur ne mesataren e fitimit bruto per liter 0,10 euro. Te njejten mesatare e ka realizuar edhe ne vitin 2017 dhe 2019. Prandaj, pëcaktimin e marzhes e ka mbajtur ne raport me verat dhe percaktimet qe kompania ka pasur të parashikuara, e assesi duke bere marreveshje apo duke bashkevepruar me kompanite tjera, kjo per faktin se ne disa muaj fitimi BRUTO/L ka qene vetem 0,05 euro. Ndersa logaritjet e bera nga e paditura se gjoja paditesa paska pasur marzhe 124% jane edhe matematikisht te pasakta dhe rrjedhimisht të pakuptueshme per Petrol Company. Po ashtu, marreveshje per caktimin e marzhes se fitimit bruto as qe mund te caktohen mes kompanive, kjo per shkak te rethanave te veçanta individuale te seciles kompani.
10. Thekson se Autoriteti ka deshtuar te arsyetoj nese paditesja eshte gjorbitur per shkak se e njejta ka hyre në marrëveshje te fshehte apo eshte perfshire ne praktika te bashkerenduar. nocione dhe veprime ligjore keto komplet te ndryshme nga njera tjetra. Neni 4 para. 1 i Ligjit per Mbrojtjen e Konkurrences Nr. 03/L-229 (tash e tutje LMK), baza kryesore ligjore ne te cilin mbeshtetet vendimi kontestues, ndalon marreveshjet që mund te çrregullojnë konkurrencen ne treg dhe praktikat e

bashkërenduara, ligji e bëne dallim e prere mes marrëveshjeve të shkruara apo jo të shkruara, të fshehura apo jo të fshehura dhe praktikave të bashkërenduara. Pra nuk janë i njëjti nocion apo shkelje e rregullave të konkurrencës.

11. Vendimi kontestues i Autoritetit në preambulen e tij referohet në nenin 3 para.1.2 [Praktikat e Bashkërenduara], e cila praktiken e bashkërenduar e kualifikon si bashkëpunim jo formal mes ndermarrjeve ekonomike dhe e cila nuk bazohet në marrëveshje. E paditura në pikën I të dispozitivit të vendimit kontestues, nuk është e sigurt se për cilën shkelje ka gëbur kompaninë Petrol Company, pasi që potencën se kompania në fjalë ka çrregulluar konkurrencën si rezultat i përfshirjes në marrëveshje të ndaluar apo praktike të bashkërenduar. Nuk mund të jenë të dyja së bashku në të njëjtin rast, sepse janë alternative "ose".
12. Sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian, të cilin Autoriteti sipas neni 66 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ishte i detyruar ta marrë për bazë zbatimin e këtij ligji. Gjykata Evropiane e Drejtësisë në disa vendime të sajë qartazi ka sqaruar se ka nënkupton praktika të bashkërenduar. Në rastin Case C-8/08 T-Mobile Netherlands and Others ECLI:EU:C: 2009:343, para 26, nënkupton në praktike të bashkërenduar mes ndermarrjeve por e cila nuk e ka arritur shkallën e një marrëveshjeje. Joined Cases 40/73 to 48/73, 50/73, 54/73 to 56/73, 111/73, 113/73 and 114/73 Suiker Unie and Others v Commission [1975] ECR 1663, paragraph 26, and Joined Cases C-89/85, C-104/85, C-114/85, C-116/85, C-117/85 and C-125/85 to C-129/85 Ahlström Osakeyhtiö and Others v Commission [1993] ECR I-1307, paragraph 63. Nga formulimi dhe praktika e Gjykatës Evropiane, rezultojnë se një veprim i caktuar i ndermarrjeve ekonomike, nuk mund të jetë edhe praktike të bashkërenduar edhe marrëveshjeje, çoftë ajo e shehur ose jo. Një veprim i ndermarrjeve ekonomike ose duhet të kualifikohet si marrëveshjeje ose si praktike të bashkërenduar, por assesi dyjat se bashku me një veprim të vetëm sic është përshkruar në pikën I të dispozitivit të vendimit. Sipas vendimit kontestues paditesja është hetuar për marrëveshjeje të fshehur dhe abuzim të pozitës dominuese, por jo dhe për praktike të bashkërenduar. Meqenëse nuk është hetuar për praktike të bashkërenduar as ligjrisht për këtë nuk mund të gjëbetet.

13. Konsideron se vendimi i kundërshtuar tek të Gjeturat dhe Analizat e Konkurrences Autoriteti ju ka referuar nje dokumenti kornize te Komisionit Evropian edhe pse i njejt i nuk ka karakter detyrues ligjore, si sqarim per marreveshjet e fshehura, por që vendimi i saj kontestues është ne kundërshtim edhe me vetë këtë dokument në te cilin referohet. Sipas pikes ii te cituar nga Autoriteti marreveshje e heshtur mund te linde kur firmat bashkeveprojne në menyre te persëritur. Autoriteti as nuk ka pretenduar se paditesi ka bashkevepruar me pare me kompanite e tjera me veprim te persëritur. Vendimi kontestues konsideron si marreveshjet e heshtur, firmat duhet te kene rene dakord qe te ruajne çmime të caktuara dhe çdo devijim nga rruga e koluzionit do te shkaktonte nje hakmarrje, por me asnjë e-mail apo dicka te ngjashme nuk ka deshmuar se kompanite e derivateve te naftes kanë rënë dakord per çmime te caktuara.
14. Ne rastin konkret, paditesja eshte hetuar per marreveshje te ndaluar por eshte ndeshkuar per praktike te bashkerenduar per te cilën nuk eshte parapare gjoba. Kjo bie ne kundërshtim me parimin e ligishmerise te percaktuar ne nenin 3 pika 3 të Ligjit Nr.05/L-087 per Kundervajtje. Sa i përket mënyrës se reflektimit të çmimeve të naftës në berzë, e paditura iu referohet vetem si pretendime, sepse nuk ka sqaruar ne baze te cilave kriteret cilave afateve kohore çmimet të reflektohet ne treg, sepse sasia qe shitet per javët apo muajt e ardhshem eshte nga stoqet qe jane ble dhe jo domosdoshmerisht me çmim të ulur.
15. Nuk eshte kontestuese mes palëve se barra e proves per te deshmuar shkeljen bie mbi Autoritetin, siç eshte cekur edhe nga vendimi kontestues ne fage 8 pika 5, e njëjta praktike eshte edhe ne Bashkimin Evropian ne fushen e te drejtës se Konkurrences, ku barra e proves bie mbi Komisionin Evropian. Mirepo e paditura ka dështuar te permbushë këtë obligim ligjor, që të argumentoj vendimin e tij kontestues, e jo vete te leshohet ne pretendime dhe hipoteza te pavertetuara me nje dokument apo shkrese te vetme. U.A 07/2012 ku ne nenin 19 par.2 parasheh qe "Autoriteti ishte i detyruar pas paraqitjes se kerkeses, te verësoj çdo deshmi te dhene. Deshmit e drejperdrete te cilat mbeshtetësin faktet e caktuara që konstatohen ne procedure, si që jane deklaratat e shkruara, shkresat, korrespondencat e drejperdrete elektronike midis pjesemarrësve ne kartel dhe dokumente tjera te shkruara me rendesi per gjetjen e fakteve dhe rethanave per

ekzistencen dhe kohezgjatjen e kartelevë në parim do të kenë vlerë shtese për dallim nga provat aksesore si që janë deklaratat e pjesëmarrësve të kartelit pa prova tjera shtese për të konfirmuar deklaratën.

16. E paditura ka për obligim e të provon me prova dhe fakte marrivëshjen apo praktiken e bashkërenduar, duke ju referuar vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ.nr.24/2016 ku e paditur është Autoriteti Kosovar i Konkurrencës: "Kushtet esenciale të cilat kërkohen sipas kësaj dispozite ligjore për vendosjen e një sanksioni administrativ të cilësdo ndërmarrje është përfshirja në ekzekutimin, zbatimin ose kryerjen e marrëveshjes ose praktikës në fjalë".
17. Në rastin konkret paditësi as nuk ka pasur marrëveshje me palët tjera e për rrjedhojë as nuk ka pasur si të zbatonte një marrëveshje e cila ekziston. Përkundrazi çmimet e derivateve të naftës paditësi i ka caktuar në mënyrë individuale për secilën pikë të sajën duke marrë për bazë edhe shpenzimet specifike që ka pasur secila pikë. Po ashtu, e paditura, edhe pse pretendon se paditësi e ka rregulluar tregun, nuk sqaron se si ka ndodhur një rregullim i tillë, cilët parametra janë marrë parasysh, në çfarë mëse është rregulluar tregu, si ka ndikuar kjo tek konsumatorët. Për këtë, Gjykata Evropiane në vendimin Komisioni/Bayer 2/01 3/01 i dt. Dt.06.01.2004 përcakton se marrëveshja duhet të ketë efekt real në rregullimin e tregut.
18. Autoriteti gabimisht është thirrur dhe ka zbatuar Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2018 mbi Kriteret për Shqiptim të Mases së Sanksioneve Administrative, sepse sipas të njëjtit, shkelja e rregullave të konkurrencës duhet të ketë ndodhur me gjatëse një vit që të konsiderohet si shkelje që ka kufizuar ndjeshëm konkurrencën, sepse në të kundërtën lirohet nga neni 5 para. 2.3 i LMK.
19. Këtë e vërteton edhe vetë Udhëzimi Administrativ 01/2018 neni 2 shkonja f, ku përkufizohet se shuma baze e masës ndëshkuese shumëzohet me numrin e viteve të shkeljes. Pra sipas përkufizimit të dhënë nga vetë Udhëzimi Administrativ, në mënyrë që një shkelje të sanksionohet me gjatëse, kjo shkelje duhet të ketë zgjatur me vite, por asesi me muaj. Sepse nëse shkelja është e shkurt, me kusht që ajo të ketë ndodhur, sepse në rastin aktual as kjo nuk ka ndodhur, ajo lirohet sipas nenit 5 para. 2.3. i LMK.

20. Gjithashtu ne nenin 4 para 1 te Administrativ 01/2018 percaktohet se shkalla e perqindjes se gjobës llogaritet ne baze te dy kriterëve bazike, e para, shkalla e seriozitetit te shkeljes së ligjit dhe e dyta, numri i viteve te shkeljes se supozuar. Argument shtese ne këte pike perben edhe neni 4 para 4 ne te cilin vete Autoriteti eshte thirrur, se gjatë percaktimit te numrit të viteve, periudha me e shkurt se 6 muaj konsiderohet gjysme viti, kurse periudha me e gjate se 6 muaj llogaritet 1 vit. Pra si mund te kuptohet, shkelja duhet te kete zgjatur me vite dhe jo me muaj. Pra sipas neni 5 para. 2.3 LMK, shkelja duhet te kete zgjatur me vite dhe assesi muaj. Parimisht dispozitat e ligjit te konkurrencës ne Kosove dhe BE parashohin se shiptimi i gjobes nese Autoriteti arrin ta vertetoj dhe deshmoj shkeljen e rregullave te konkurrencës, behet per periudhen per te cilen pretendohet se ka ndodhur shkelja, po assesi nese shkelja ka ndodhur, qe gjoba te shiptohet per periudha shtese.
21. Pretendimi i AKK se 16 kompani te cilat jane ne konkurrence te vazhdueshme mes tyre jane marr vesh qe te mbajne marzha te larta pa i pasur çmimet e njejta është pretendim i pa bazuar ne prova por edhe pa logjik ekonomike. AKK nuk ka marrë për bazë se paditësja ne pikat e veta ka pasur çmime te dryshme gjate periudhes kontestuese. Nuk dihet as permbajtja e marreveshjes, cilat kanë qene detyrimet e palëve kinse te perfshira ne marreveshje, a është respektuar marrëveshja dhe nga kush, ku dhe kur është lidhur kjo marrëveshje etj, e paditura nuk e ka marrë për bazë se rrethanën se si paskan ndikuar 16 kompani ne çrregullimin e tregut nga gjithsej 850 pika te shitjes me pakice ne Kosove e ku kompanite tjera nuk kane marr pjese ne hetim nga e paditura.
22. E tërë baza e vendimit te atakuar te te paditures, qëndron ne normen me te larte te fitimit bruto te realizuar nga paditësja ne dy muajt e fundit te vitit 2018. Sipas te paditures, ky fitim eshte arritur me mbajjen e mimeve te larta te produkteve te naftes dhe benzines, perkunder se mimi bleres i tyre kishte rene. Po ashtu, sipas te paditures kjo sjellje perputhet me sjelljen e konkurrenteve t paditises, te cilët gjithashtu nuk kishin reflektuar ne zbritje te mimit shites te derivateve.
23. Nuk ka ndonje prove te vetme te administruar giate kesaj procedure, e cila verteton se paditësja ka mbajtur mime me te larta te produkteve, ne bashkerendim me konkurrentet e saj. Ekzistenca e mimeve te ngjashme (edhe pse as ato nuk kane qene

te njejta) mund te jete baze per dyshim dhe inicim te procedures hetimore, mirepo në anje rethanë nuk mund te jete si baze e vetme per konstatimin e ekzistences se nje praktike te bashkerenduar.

24. Paditisja ka vepruar ne treg si e pavarur, duke marre vete vendimet ekonomike ne perputhje me interesat e saj. Ne qofte se keto vendime jane perputhur me vendimet e nj kompanie konkurrenente, atehere nje gje e tille nuk verteton se ka ekzistuar bashkërendim mes tyre. Siç vete e paditura e thekson ne pergjigen ndaj padise, sjelljet autonome te kompanive shpesh sjellin ne praktika paralele te pakoordinuara mes tyre. Nese ne rastin konkret ka pasur sjellie paralele, atëhere padyshim se kjo eshte ajo fare ka ndodhur, posaçerisht duke pasur parasysh se tregu i derivateve eshte mjaft transparent, ku secila prej kompanive ne pikat e saj te shitjes mban tabela ne te cilat tregohen çmimet e produkteve.
25. Kjo është sqaruar edhe në ne raportin e eksperti i cili ka gjetur se paditisja ne vitet 2017 dhe 2018 ka pasur marzhe identike te fitimit, ne lartesi prej 11.20%. Pra, ekspertiza e ka vertetuar arsyen e dhene nga paditisja lidhur me nivelin e çmimeve ne dy muajt e fundit te vitit 2018, e që ka qene pra realizimi i normes se pritur vjetore te fitimit per liter. Ne kete menyre, ekspertiza e nxjerre në kete konflikt administrativ, i ka vertetuar me tej pretendimet ne kërkesëpadi. I propozon gjykatës që të aprovoj kerkesepadinë e paditësit Petrol Company Sh.P.K me seli ne Prishtine dhe të anuloj Vendimi i Autoritetit Kosovar te Konkurrences nr. 41/2020 me numer prot. 165/20-0210 i datës 06.05.2020 si i kundërligjshem.

Kundërshtimet e të paditurës

26. Përfaqësuesi i të paditurës Autoriteti i Konkurrencës, në përgjigje në padi në fjalën përfundimtare dhe në përgjigje në padi si dhe në deklarimet gjatë seancave ka deklaruar se qëndron ne tërësi prapa Vendimit Nr.41/2020 dt.06.05.2020, sepse me te gjitha provat e prezentuara është vërtetuar bindshëm si i bazuar Vendimi i Autoritetit të Konkurrences Nr. 41/2020 dt. 06.05.2020 me të cilin vendim Petrol Company Sh.p.k., i është shqiptuar sanksioni administrativ në shumën prej 191,535. 22 €, për shkak të shkeljes se Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrences nr. 03/L-229,

saktësisht ka çrregulluar konkurrencën tregtare gjatë muajve Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2018, e që me këto veprime ka kryer shkelje të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Kjo shumë i është shqiptuar si masë ndëshkuese administrative në shumën prej 3 % të totalit të të hyrave për gjashtë mujorin e vitit 2018. Mjetet nga masa ndëshkuese administrative do të transferoheshin në buxhetin e Republikës së Kosovës.

27. Deri të vendimi për shqiptimin e masës ndëshkuese, ka ardhur pas monitorimit të tregut, një sërë analizash ekonomike dhe statistikore, e të cilat prova gjenden në shkresat e lëndës. Me anë të këtyre provave, e paditura vlerëson se është vërtetuar bindshëm se "Petrol Company Sh.p.k.," me vetedije ka hyrë në një bashkërendim me ndermarrje tjera të cilat operojnë në tregun relevant në shitje me pakicë të derivateve të naftës dhe benzines. Sjellja e kompanisë e bashkërenduar me konkurrentet të tjere në lidhje me çmimet ka ndodhur heshturazi në formë të tërthorte në mes tyre duke ndikuar në përcaktimin e mimit dhe kushteve jera tregtare, me qëllimin e vetëm për të maksimizuar profitin e tyre, në dëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës, e që veprimi i tillë për autoritetin konsiderohet detyrim për mbrojtje të interesit publik.
28. Forma e caktimit të çmimit apo marzha e fitimit për muajt Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2018, në krahasim me muajt paraprak nga Janari deri Tetor të këtij viti, është tregues i qartë se kompanitë në mesin e të cilave dhe "Petrol Company Sh.p.k.," duke bashkërenduar praktikën kanë shumëfishuar fitimin e tyre, për kundra uljeve në bërza. Fakti që çmimet e blerjes së derivateve të naftës në bërza shënojnë ulje për 8%, e ndërmarrjet tona, në mesin e të cilëve dhe "Petrol Company Sh.p.k.," e ngrisin mimin për 4 % dhe mesatarja e fitimit bruto shkon në 124 %, kjo me se miri flet se ky treg ishte i kontrolluar dhe me marrëveshje e heshtur/praktike e bashkërenduar. Nuk mund të ketë fitim kaq të madh pa u dhjetëfishuar numri i konsumit, por një gjë e tillë ishte e pamundur po të mos ekzistonte një marrëveshje e heshtur/praktike e bashkërenduar mes këtyre ndermarrjeve çmimet do të pësonin rënie, sepse kjo ishte logjika ekonomike, sepse si shpjegohet ndryshe e tërë kjo.
29. Ka deklaruar se Praktikë e bashkërenduar konsiderohet bashkërendim midis ndermarrjeve të cilat pa arritur fazën e nënshkrimit të një marrëveshjeje zyrtare, me

dijeni, kryejne bashkepunim praktik per te shmangur rrezikun e konkurrences. Nje praktike e bashkërenduar mund te realizohet me kontakte te drejperdrejta ose te terthorta midis firmave, synimi apo rezultati i te cilave është qe te ndikohet sjellja e tregut ose t'u jepet informacion konkurrenteve ne lidhje me veprimet e ardhshme.

30. Pala e paditur eshte institucion publik, i pavarur ne kryerjen e detyrave te veta te percaktuara ne Ligjin 03/L-229 per Mbrojen e Konkurrences si dhe Plotesim ndryshimi i ketij Ligji 04/L- 226, per te cilat i pergjigjet Kuvendit te Republikes se Kosovës. Ka deklaruar se Praktikë e bashkërenduar konsiderohet bashkërendim midis ndermarrjeve te cilat pa arritur fazen e nenshkrimit te nje marreveshjeje zyrtare, me dijeni, kryejne bashkepunim praktik per te shmangur rrezikun e konkurrences. Nje praktike e bashkërenduar mund te realizohet me kontakte te drejperdrejta ose te terthorta midis paditësit me 16 firma të tjera, synimi apo rezultati i te cilave është qe te ndikohet sjellja e tregut ose t'u jepet informacion konkurrenteve ne lidhje me veprimet e ardhshme. Vendimi është i xjerrur per palën Petrol Company sh.p.k, duke perfshire gashtedhete (60) njesite, pikat e shitjes sipas ARBK-se, e jo si tenton perfaqësuesit e pales paditësit që njesite ti konsideron kompani te pavarura, e jo ne kuadër të kompanisë si njësi, pika shitëse
31. Kurse konkurrenca i takon nje sferë te veçante për të cilën e paditura është përgjegjësë për vlerësim. Politika e menaxhimit te biznesit me dallim te shitjes se derivateve deri ne 15 cent dallim ne mes te pikave te vete Petrol Company, te Medreseja, Prishtine, Peje dhe Arberi, Prishtinë, askush nuk mund te nderhyje por gjithesesi edhe kjo jep indikacione per bashkërendim brenda vete Kompanise ne menyre te heshtur me Kompanite tjera, ne periudhat e caktuara te vitit, perkatesisht gate muajve Nentor- Dhjetor.
32. Pretendimet e pales per shkelje te Nenit 86, 88 dhe 89 te LPPA, janë të pabazuara sepse bashkepunimi ka qene me institucione kredibile qe veshtire mund te rrezohet besueshmeria ne kompetencen e tyre Institucionale, sa i perket informacioneve per bizneset, sepse dokumentacioni shte siguruar nga vete Petrol Company sh.pk., Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosoves, Ministria e Tregtise dhe Industrise (MTI) dhe Ministria e Financave (MF).

33. Ka deklaruar se është me interes të permendet deklarata në seancën degjimore e pronarit të "Petrol Company" SH.P.K., z. Sh.J.: "Sa i përket çmimeve paralele, unë theksova se çmimet mund të jenë shumë të ngjashme për arsye të furnizimit të taksave dhe të gjitha shpenzimeve të barabarta ose të përafërta që i kemi. Ndërsa sa i përket përcaktimit të çmimeve në bazë të konkurrencës ka mundësi që stafi jone mos ta ketë pas mundësinë ose diçkë tjetër që duhet të interpretuar mjaftueshëm qartë, për shkak se nëse klientët e caktuar vijnë te ne dhe deklarojnë se dikur jeter e kanë gjete derivatin me një çmim më të lirë, por po donë më të ble tek ne, në ato momente i ofrojmë çmimet me zbritje sepse neve Kushtetuta na e lejon një gjë të tillë, si ekonomi e tregut dhe ne e përcaktojmë në bazë të rrethanave edhe çmimet shitese, në këtë rast menagjerët tanë bëjnë zbritjet e caktuara, që atij blerësi t'i plotësohen kërkesat".
34. Nga kjo rezulton se çmimet përcaktohen kemi të bëjmë me një praktikë të bashkërenduar që realizohet me kontakte të drejtperdrejta ose të tërthorta midis firmave, synimi apo rezultati i të cilave është që të ndikohet sjellja në treg ose t'u jepet informacion konkurrentëve në lidhje me veprimet e ardhshme. Disa tregje oligopolistike, në kushte të caktuara, ndër to edhe Nafta mund t'u mundësojnë ndermarjeve të mbajnë politika të përbashkëta pa hyrë në marrëveshje ose praktikë të bashkërenduar. Në tregje të tilla, sjellja racionale dhe e pavarur e ndermarreve mund të çojë në sjellje paralele pa hyrë në bashkëpunim. Ky fenomen shpesh referohet nga ekonomistët si "bashkëpunim i fshehtë i heshtur" ose "paralelizim i ndergjegjshëm". Nga këto veprime, sjellje konstatohet se kjo praktikë është e bashkërenduar e rijedhimisht e kualifikon si marrëveshje të heshtur (Tacit Collusion), dhe që ka çrregulluar konkurrencën tregtare duke kryer shkelje të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr.03/L-229, Nenin 4 Marrëveshje e ndaluar apo praktikë e bashkërenduar paragrafi 1 nën paragrafi (1.1.)
35. Argumenti se nuk janë zhvilluar hetime për praktikë të bashkërenduar ishte i pasaktë dhe fshehtë e procedurës kundërshtarëve kompanisë dhe këto e vërtetojnë shkresat dhe njoftimet e dërguara për kompaninë Petrol Company Sh.p.k.
36. Në lidhje me praktikën e bashkërenduar të cilat kanë për qëllim ose mund të nikojnë në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant i

referohet Prof. R.W. dhe D.B. ne librin Competition Law (E drejta e konkurrences Botimi i shtate, 2012, kanë sqaruar ne lidhje me Marreveshje 'dhe/ose' praktika e bashkërenduar, Komisioni ka deklaruar se marrëveshjet dhe praktikat e bashkërenduara jane konceptualisht të dallueshme¹⁸⁶. Megjithate, Avokati i Pergjithshem Reischl ka thene se ka pak kuptim në percaktimin e pikes se sakte ne te cilën mbaron marreveshja dhe fillon praktika e bashkërenduar¹⁸⁷. Mund te ndodhe që, ne nje rast te veçante, nga ana gjuhesore është më e natyrshme te perdoret nje term se tjetri, por ligerisht asgje nuk e kthen ne dallimin: dallimi i rendësishem eshte midis sjelljes se fshehte dhe jo-koluzive¹⁸⁸. Ndonjehere Komisioni do te thotë se, edhe nese kontaktet ndermjet konkurrenteve nuk perbejnë nje marreveshje, ato persri mund te karakterizohen si nje praktike e bashkërenduar¹⁸⁹. Në PVC¹⁹⁰, Komisioni arriti në perfundimin se palët ne kartel kishin marre pjesë ne nje marreveshje 'dhe/ose' ne nje praktike te bashkerenduar. Ne apelin e Gjykates se Pergjithshme Enichem argumentoi se Komisioni nuk kishte te drejte te bente këtë "klasifikim te perbashkët". Ne vendimin e saj, Gykata e Pergjithshme e hodhi posht kete argument dhe la ne fuqi Komisionin¹⁹¹. Ai u shpreh se: Ne kontekstin e nj shkeljeje komplekse qe perfshin shume prodhues qe kerkojne gjatë disa viteve te regullojne tregun ndermjet tyre, nuk mund te pritet që Komisioni ta klasifikoj shkeljen saktesisht, per do ndermarje dhe per do moment te caktuar, si në çdo në rast se te dyja këto forma të shkeljes mbulohe nga neni [101] i Traktatit 192.

37. Gjykata e Drejtesise ne Commission v Anic¹⁹³ dhe ne Asnef-Equifax 194 ku, ne rastin e bashkëpunimit ndermjet konkurrenteve ne formën e nje shkembimi indirekt informacioni, doli ne perfundimin se nuk kishte nevojë te karakterizohej bashkepunimi ne fjale specifikisht si nje praktike e bashkerenduar, nje marreveshje ose një vendim i nje shoqate ndermarjesh.

38. Në lidhje me praktikën e bashkërenduar i referohet Rastit IV/37.614/F3 PO/Interbreë and Alken -Maes, [2003] OJ L200/1 Komisioni vuri ne dukje se "Konceptet e "marreveshjes" dhe "praktike e bashkerenduar" janë te ndryshueshme dhe mund te mbivendosen. Realisht, madje mund te jete e pamundur te behet nje dallim i tille, pasi nje shkelje mund te kete njekohesisht karakteristikat e te dyja formave te sjelljes se ndaluar, ndersa, te marra veçmas, disa nga elementet e saj

mund te konsiderohen sakte si njeri dhe jo forma tjetra. Do te ishte githashtu artificiale nga pikepamja analitike ge te ndahej ne disa forma shkeljeje, ne menyre te qarte, nje siper marrje e vazhdueshme kolektive me nje objektiv te vetem. Një kartel per shembull mund te perbeje nje marreveshje dhe nje praktike te bashkërenduar në te njejtën kohë... (para 233)

39. Argumentimi se eshte e paditura është gjobit per çeshtje qe nuk ishte hetuar, është i pasakte Neni 4 paragrafi 1 i Ligjit eshte shume i qarte dhe baze ligjore e parrezueshme, e pakontestueshme per hetime dhe gjobë. Kreu II Marrëveshjet e Ndermarrjeve, Neni 4 Marrëveshjet e ndaluara 1. Ndalohen te gjitha marreveshjet ndermjet dy ose me shume ndermarrjeve te pavarura, vendimet e marrura ne mes te shoqatave te ndermarrjeve dhe praktikat e bashkrenduar te cilat kane per qellim ose mund te ndikojne ne menyre te dukshme ne qrrregullimin e konkurrences tregtare ne tregun relevant...].
40. Gjithashtu, me provat e administruara ne seancen gjyqësore te dates 16.04.2024 u vërtetua se padia dhe kerkesa ge derivon per anulimin e Vendimit eshte teresisht e pabazuar, dhe me asnjë prove pala paditese nuk ka mundur te vertetoje bazueshmerine e saj. Nuk ka prezentuar asnje prove te vetme, e cila eventualisht do te provonte pretendimet se padia-kerkespadia shte e bazuar. Nderkaq, ekspertiza e perpiluar nga Eksperti Financiar A.L. e dt. 08.03.2024 nuk e ndryshon giendjen faktike, por vetem sakteson çeshtjen e marzhes se fitimit dhe ate per tëre vitin kalendarik 2017 dhe 2018. E paditura ne Vendimin e atakuar ka marre per baze marzhën e fitimit per muajin Nintor dhe Dhjetor te 2018, dhe ka krahasuar me marzhen e fitimit me muajt paraprak, saktesisht nga muajin Janar deri ne muajin Tetor te 2018, dhe diferenca e fitimit ka qene shume e madhe ne dymujorin e fundit, ne krahasim me muajt paraprak. Eksperti nuk ka berë një krahasim te tille, mirëpo ka krahasuar komplet vitin 2018 me 2017 duke konstatuar se marzha e fitimit per vitin 2017 dhe 2018 per Petrol Company ka qene 11.20 %. Askund eksperti nuk e sqaron fitimin e shumëfishuar te muajve Nëntor dhe Dhejtor 2018 në krahasim me muajt paraprak te vitit 2018. Po ashtu bnë perpilimit te ekspertizes ka marre per baze shitjet me shumice dhe pakicë te derivateve te naftes dhe benzines, ndersa Autoriteti ka hetuar dhe ka marre Vendim vetem per shitjet me pakice te derivateve te naftes dhe benzines.

41. E paditura Autoriteti i Konkurrences i Republikes se Kosoves, i propozon Gjykates që padine-kerkespadine e paditesit "Petrol Company" per Anulimin e Vendimit Nr.41/2020, ta refuzoje ne teresi si te pabazuar dhe ta aprovoj masën ndeshkuese administrative ne shume prej 3% te totalit te te hyrave per 6 mujorin e vitit 2018, ne vlere prej €191,535.22.

Provat e administruara

42. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi me Nr.Prot:165/20-0210 të datës 06.05.2020, Procesverbal i AKK me datë 13.02.2020, Komentet e paditësit Petrol Company SH.P.K ndaj njoftimit të fakteve paraprake të konstatuara në procedurë me nr. 370/19 të datës 21.11.2019, Njoftim për konstatim të gjendjes faktike nga departamenti për mbikëqyrjen e tregut për paditësin Petrol Company SH.P.K me nr.35/20, Njoftim i fakteve paraprake të konstatuara në procedurë nga departamenti për mbikëqyrjen e tregut për Petrol Company SH.P.K me nr.370/19 me datë 21.11.2019, Ekspertiza financiare të punuar nga eksperti A.L. me datë 08.03.2024.

43. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Vlerësimi i Gjykatës

44. Gjykata vlerëson se e paditura ka iniciuar procedurën e hetimit konform nenit Neni 35 të Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, të plotësuar dhe ndryshuar më LIGJIN NR. 04/L-226 (LMK), ku përcaktohte se Autoriteti e fillon sipas detyres zyrtare Procedurën e konstatimit të marrëveshjeve të ndaluara nga neni 4 i këtij ligji, si dhe procedura për konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese nga neni 12 i këtij ligji, dhe Neni 36 të Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

45. E paditura Autoriteti Kosovar i Konkurrences Departamenti i Mbikëqyrjes se Tregut me datë 21.11.2019, e ka njoftuar paditësin se është duke zhvilluar procedure hetimore ne tregun e derivateve te Naftes ne Republikën e Kosoves bazuar ne Konkluzionin Nr. 01/19 i dt. 15.02.2018 i Komisionit te AKK-se per fillimin e procedurave hetimore ne tregun perkates, duke u bazuar ne Ligjin per Mbrojtjen e Konkurrences, nr. 03/L-229, neni 45, i ka dërguar Njoftimin e Fakteve Paraprake te Konstatuara ne Procedure dhe bazuar ne nenin 45 par. 1 dhe 2 palët e ka ftuar paditësin ti paraqes komentet e tyre ne njoftim ne afat prej (1) muaji nga dita e marrjes se njoftimit.
46. Autoriteti Kosovar i Konkurrences pas marrjes se Konkluzionit nr. 01/19 i dt. 15.02.2019 per fillim e procedures hetimore ndaj ndermarjeve te cilat operojne ne tregun e derivateve te naftes per shkak te dyshimeve te bazuara per ç'rregullim të konkurrences në kundërshtim me nenin 4 "Marrëveshje te ndaluar" dhe nenin 11 "Abuzim me Pozitën Dominuese", Autoriteti ka bërë mbledhjen dhe analizën e te dhenave gjate procedures hetimore per ndermanjen "Petrol Company" ShPK Nr. Fiskal: 600118120. Autoriteti Kosovar i Konkurrences ka analizuar dokumentet e kerkuara me Konkluzionin nr. 01/19 i datës 15.02.2019 per ndermarren "Petrol Company" ShPK Librin e blerjes nga 01.01.2018 deri më 31.12.2018, (fizike dhe ne forme elektronike), Librin e shitjeve nga 01.01.2018 deri më 31.12.2018, (fizike dhe në forme elektronike), Kontratat dhe aneks kontratat e tendereve te fituar prej 01.01.2018 deri me 31.12.2018, Qarkullimin vjetor te ofruar nga ATK - 01.01.2018 - 31.12.2018, Të gjitha importet nga Dogana me 01/01/2018 - 31/12/2018, Faturat e kerkuara nga Autoriteti, Procesverbali i datës 18.07.2019 i mbajtur me perfagësues të PETROL COMPANY ShPK, Numrin e pikave të shitjes, të dhenat sasiore mbi shitjen me pakicë dhe shumicë per nafte dhe benzine, Kapacitetet e depove të derivateve të naftes, sasia e stoqeve. Nga këto dokumente ka analizuar strukturën e tregut per secilin ndermarrje te cilat afarojne ne tregun e derivateve te naftës per periudhën 12 mujore te vitit 2018. Nga të cilat ka konstatuar se ndermarrjet te cilat operojne ne tregun relevant shitjes me pakicë të produkteve të naftës dhe benzine nuk kane reflektuar ne mënyrë individuale duke marr per baze çmimin e shitjes se fitimin bruto/l per muajin Nentor dhe Dhjetor për produktin

benzinë kanë pasur fitimin bruto/l përafërsisht 12% për muajt Janar - Tetor ndërsa për muajin Nëntor, në mënyrë të bashkërenduar kanë realizuar fitimin bruto/l.

47. Nga Njoftimi i fakteve paraprake të konstatuara në procedurë me nr.3370/19 i datës 21.11.2019, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun relevant¹ (shitje me pakicë-naftë), nuk kanë reflektuar në mënyrë individuale marrë për bazë çmimin e shitjes dhe fitimin bruto për muajin Nëntor e Dhjetor. Që do të thotë se, ndërmarrjet të cilat janë në procedurë hetimore, kanë pasur fitim bruto përafërsisht 9% për muajt Janar –Tetor, ndërsa për muajin Nëntor, në mënyrë të bashkërenduar kanë realizuar fitimin bruto mesatarisht 60% dhe për muajin Dhjetor 124%, ndërsa ka konstatuar se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun relevant (shitje me pakicë-benzine), nuk kanë reflektuar në mënyrë individuale marrë për bazë çmimin e shitjes dhe fitimin bruto për muajin Nëntor dhe Dhjetor, që do të thotë se ndërmarrjet të cilat janë në procedurë hetimore, kanë pasur fitimin bruto përafërsisht 12%, për muajt Janar-Tetor, ndërsa për muajin Nëntor, në mënyrë të bashkërenduar, kanë realizuar fitimin bruto mesatarisht 108% dhe për muajin Dhjetor 135%.

48. Paditësi është njoftuar se sipas Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 56 "Masa ndeshkuese në një shumë deri në dhjetë për qind (10%) të totalit të të hyrave që ndermarrja e ka realizuar në vitin e fundit për të cilin është perfunduar raporti financiar, ndeshkohet nëse konstatohet se ka lidhë marreveshje të ndaluar ose në ndonjë mënyrë tjetër merr pjesë në marreveshjen me të cilën është çrregulluar konkurrenca, në mënyrën e përshkruar në dispozitën e nenit 4 të këtij ligji.

49. Me datë 31.01.2020 Ndermarrja "PETROL COMPANY ShPK" është ftuar për seance degjimore bazuar në nenin 47 i Ligjit nr. 03/L-229 dhe plotësim ndryshimin nr. 04/L-226, për Mbrojtjen e Konkurrencës, qëllim për të paraqitur informacionet

¹ Neni 3 i ligjit bazik 1.8. përkufizon Tregu Relevant - fushën e tregtisë për të cilën konkurrenca është kufizuar në një zonë të caktuar gjeografike, duke përfshirë të gjitha produktet dhe shërbimet e zëvendësueshme për të cilat konsumatorët mund të drejtohen në afat sa më të shkurtër, në rast se kufizimi apo abuzimi rezultojnë në ngritjen e çmimit;

apo provat e reja bazuar ne faktet e pranuar lidhur me konstatimin e shkeljeve ligjore me rastin e derivateve te naftes.

50. Me datë 31/01/2020, Nr. 35/20 Departmenti per Mbikegyrjen e Tregut ka përpiluar Njoftimin per Konstatimin e Gjendies Faktike për Ndermarjen "Petrol Company" Sh.P.K. si dhe proceduren e konstatimit te kushteve per Shiptimin e Masës Ndeshkuese. Autoriteti ka vlerësuar dhe analizuar komentet e ndermarjes "Petrol Company" Sh.P.K., të dorëzuara me dt. 20.12.2019 me Nr. prot. 416/9-01/H brenda afatit ligjor ka ofruar Autoritetit "Komentet ne lidhje me Njoftimin e fakteve paraprake te Konstatuara ne procedure" ne baze te te cilave konstaton se nuk ka fakte ose prova të reja te cilat e ndryshojne konstatimin e gendjes faktike.
51. Ndërsa ka konstatuar se bazuar në evidencën e e te dhenave, sjellja e ndërmarrjes "Petrol Company" Sh.P.K. në tregun perkates ka çrregulluar konkurrencën tregtare për muajt Nentor dhe Dhjetor 2018 me veprime të cilësuar si "Marreveshje te ndaluar apo praktike e bashkërenduar", në shkelje të Ligjit për Konkurences Nr. 03/-229, nenin 4 ", paragrafi 1 nën paragrafi (1.1), ashtu që ndermanja "Petrol Company" Sh.P.K. ne mënyre te bashkërenduar/heshtur me ndermarje tjera kane caktuar çmimin e shitjes me pakice te produktit naftë dhe benzine per periudhen Nentor e Dhjetor 2018 me vetëdije me veprime që kanë ndodhur heshturazi ne forme te terthorte ne mes tyre duke ndikuar ne percaktimin e çmimit dhe kushteve tjera tregtare me qëllimin e vetem per te maksimizuar fitimin.
52. Në procesverbalin e seancës degjimore të mbajtur me datën 13.02.2020 per rastin Nafta, me perfaqësuesit e kompanisë PETROL COMPANY SHPK, perfaqësues i "Petrol Company" Sh.P.K. – ka deklaruar se komenteve e dorezuara ne forme te shkruar nuk jane marr parasysh më arsyetim se "Petrol Company" Sh.P.K. ne percaktimin e çmimit te saj ka vepruar ne menyre krejtesisht te pavarur nga konkurrentet e tjere nuk ka qenë pjese e asnje marreveshje as formale e as jo formale as te shkruar e as te heshtur, I kanë dorëzuar ne forme tabelore dhe forme te shkruar provat me kupone fiskal, për të vërtetuar se çmimet nuk janë të njejta dhe te ngjashme me kompanite tjera por edhe ne mes pikave të kompanisë Petrol ne gjithëe Kosovën.

53. Ka deklaruar se në krahasim me tri viteve 2017,2018 dhe 2019, gjate vitit 2018 ka pas shume levizje te mimeve, te cilat gjate githe vitit ka pas ngritje dhe zbritje te mimeve te pa kontrolluara, për çka "Petrol Company" Sh.P.K. ka pas te pa mundshme te beje percjelljen e lëvizjeve te çmimeve dhe githmone kemi pas ngecje ne ngritjen e çmimeve. Sipas biznes planit te hartuar paraprakisht ge ka funksionuar vitin 2017, 2018 dhe vitin 2019 në tabela janë paraqitur shitjet per dizelin si produkti dominant me mbi 90% ka deklaruar se deri ne fund te vitit 2018 kemi pas raste kur kemi pas 4 cent fitim, ne shitje me pakice e cila eshte nje marzhe shume e vogel nuk del me profit, ne keta muaj paditësi ka pas humbje sepse kashpenzime te medha mbi 400 punëtor dhe obligimet bankare, per këtë arsye ne fund te vitit kur ka pas renie drastike te çmimeve, atëhere "Petrol Company" Sh.P.K. ka pas nje zbritje me te ngadalshme te çmimit me qellim te arritjes se targeteve te saja financiare, por këto nuk i ka planifikuar dhe nuk ka pas as nje kontakt me asnje kompani.
54. Me Vendimin, Nr. 41/2020, Datë 6 maj 2020, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, Republika e Kosovës, konstatohet se Petrol Company Sh.p.k. me nr. Fiskal: 600118120, ka ç'rregulluar konkurrencen tregtare gjatë muajve Nëntor e Dhjetor të vitit 2018, në shkelje të dispozitave të Ligjit për Mbrojen e Konkurrencës Nr. 03/L-229, nenin 4 "Marrëveshje të ndaluar apo praktike e bashkërenduar", paragrafi 1 nen paragrafi (1.1), për çka i shpohet masa ndëshkuese administrative në shumë prej (3.00%) të totalit te te hyrave per jashte (6) mujorin e vitit 2018, ne vlerë prej € 191,535.22. Ndrërsa, nuk është konstatuar abuzim me poziten dominuese ne treg individuale apo kolektive sipas nenit 11 te Ligjit per Mbrojtjen e Konkurrences. Ndërmarrja Petrol Company Sh.p.k. urdhërohet të ndaloj çdo veprim të mëtutjeshëm qe ka të bejë me vendosjen e çmimeve ne mënyrë të bashkërenduar/heshtur me ndermarre tjera në dëm te konsumatorëve dhe çdo veprim tjeter qe ç'rregullon konkurrencen ne tregun perkates.
55. Me arsyetim se procedura e hetimit ka filluar ex officio me datë 24.12.2018 në bazë të informimit të mediave dhe shoqërisë civile dhe publikut se përkundër perkunder faktit se ka pas renie ne berzën boterore te naftes, ndermarjet që operojne ne Republikën e Kosovës ne tregun e derivateve te naftes, kane arritur marreveshje te fshehët per t'i fiksuar apo kurdisur çmimet e shitjese me shumicë dhe pakicë të

naftës dhe benzinës ashtu që nuk kane reflektuar karshi çmimit të berzes boterore. Me datën 15.02.2019 ka marre konkluzion per fillimin e procedures hetimore ndaj 16 ndermarrjeve te derivateve te naftes.

56. Gjate monitorimit ne tregun perkates ne sektorin e naftes lidhur me rastin, takimeve te zhvilluara me palët te cilet merren me importin, blerjen dhe shitjen e derivateve te naftes me shumice dhe pakice, analizimit dhe versimit te te dhenave te grumbulluara gjate monitorimit, dokumentacioni i siguruar nga Dogana e Kosoves, Administrata Tatimore e Kosoves, MTI, MF, Autoriteti Kosovar i Konkurrences ka njerre strukturen e tregut te ndermarrjeve te cilat importojne dhe tregtojne derivate te naftes me shumice dhe pakice, per ndermarrjet te cilat kanë ndikim te ndjeshëm në sektorin e tregut te naftes.
57. Bazuar ne Konkuzionin nr.01/19 i dates 15.02.2019 per fillimin e procedures, së Komisioni i Autoritetit Kosovar te Konkurrences ka pasur dyshime te bazuara per ç'rregullim te Konkurrences ne tregun e derivateve te naftes ne kundershtrim me nenin 4 "Marreveshje te ndaluar" dhe nenin 11 "Abuzim me poziten dominuese".
58. Komisioni i AKK-se ka caktuar periudhen e hetimit per ndermarrjet nen hetim nga 01.01.2018 deri me 31.12.2018, ka kërkuar nga Dogana te gjitha dudat doganor te importit te produktit Naftë dhe Benzine nga ndermarria Petrol Company Sh.p.k. Kodi tarifar per Produktin Naftë (2710194300) ndërsa per produktin Benzine (2710124500).
59. Për të kalkuluar, sasin e litrave të importuara ka larguar nga formula e kalkulimit te gjitha ato importe te cilat nuk iu kane nenshtruar akcizes nga ka konstatuar se ndermarja PETROL COMPANY Shpk ka importuar 0.0 litra (naftë dhe benzinë) per te cila importe nuk ka paguar akcize. Ndërsa gjate vitit 2018 ka importuar 21, 161,039.25 litra naftë dhe 3,574,239.40 litra benzine dhe që në total 24,735,278.65 litra derivate per vitin 2018.
60. Pjesemarja e pergjithshme ne treg per naftë dhe benzine Petrol Company Shpk eshte 3.86%, vetem per Naftë eshte 3.75%, vetem per Benzine eshte 4.66 %.

61. Autoriteti duke u bazuar në të dhënat e ofruara nga Dogana e Kosovës, strukturën e tregut e ka kalkular në këtë formë: Shuma e përgjithshme e Litrave të importuara nga ndermarrja 24,735,278.65 ndërsa shuma e përgjithshme e naftes dhe benzines në Republikën e Kosovës ishte 640,366,920.87 l.
62. Nga analiza e të dhënave është konstatuar se për produktin naftë nga muaji Janar-Tetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ka qene 0.09 cent/l ndërsa për muajin Janar-Tetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ishte 0.18 cent/l. Në krahasueshmeri për muajin Shkurt dhe Dhjetor, muaji Shkurt 2018, çmimi bleres/l ishte 0.93 cent/l ndërsa fitimi bruto/l ishte 0.10 cent/l dhe çmimi shites/l ishte 1.03 cent/l gjë që është reflektuese me çmimin e berzës botrore, ndërsa për muajin Dhjetor ku çmimi i berzes kishte rënie nga muaji paraprak dhe po ashtu çmimi importues/l ishte perafersisht i njete me muajin Shkurt 2018, 0.93 cent/l, fitimi bruto/l për muajin Dhjetor ishte 0.21 cent/l dhe çmimi shites/l ishte 1.14 cent/l nga rezultojnë së ndermarrja Petrol Company ShPK nuk ka reflektuar me ulje të fitimit bruto/l karshi uljes së çmimit të berzes dhe çmimit importues. Mbi këto baze ligjore dhe faktet e konstatuara, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, ka konstatuar se e ndermarrja Petrol Company ShPK ka caktuar çmimin shitjes dhe marzhën e fitimit bruto/l për muajin Nëntor dhe Dhjetor në mënyrë të bashkërenduar me kompanite/ndermarrjet tjera të cilat operojnë në tregun relevant, në shitje me pakicë, në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-229 dhe plotësim ndryshimi i tij nr. 04/L-226, për Mbrojtjen e Konkurrencës, ku theksohet se: cakton, në mënyrë të dretpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi dhe kjo formë e bashkëpunimit sanksionohet me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës. Në baze të këtyre të dhënave Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka vlersuar se gjatë muajve Janar - Tetor ndermarrjet të cilat operojnë në tregun përkatës kanë pas një dallim të çmimit shites nga çmimi bleres mesatarisht rreth 9% fitimi bruto/l. Ndërsa gjatë muajit Nëntor krahasuar me mesataren e muajve Janar - Tetor, çmimi bleres/l ka rritje për 2.0% ndërsa çmimi shites/l krahasuar me muajt, është rritur për 7% dhe mesatarja e fitimit bruto/l është rritur për 60% në raport me fitimin bruto/l për periudhën Janar - Tetor. Ndërsa gjatë muajit Dhjetor krahasuar me mesataren e muajve Janar Tetor, çmimi bleres/l ka rënie për 8% ndërsa çmimi shites/l ka rritje

per 4% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajit Janar - Tetor eshte ritur per 124% ne raport me periudhen e njejte.

63. Nga kjo Autoriteti ka konstatuar se ndermarrjet te cilat operojne ne tregun relevant (shitje me pakice) nuk kanë reflektuar në mënyre individuale marre per baze çmimin të shitjes dhe fitimin bruto/l per muajin Nëntor e Dhjetor te produktit naftë per muajt Janar - Tetor kane pasur fitimin bruto/l perafersisht 9%, ndersa per muajin Nentor, ne menyre te bashkerendar kane realizuar fitimin bruto mesatarisht 60% dhe per muajin Dhjetor 124% ne raport me periudhën Janar - Tetor.
64. Për produktin benzin nga muaji Janar-Tetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ka qene 0.12 cent/l, ndersa per muajin Janar-Tetor 2018 mesatarja fitimi bruto/l ishte 0.28 cent/l. Në krahasim me muajin Shkurt dhe Dhjetor 2018, në Shkurt çmimi bleres/l ishte 0.95 cent/l ndersa fitimi bruto/l ishte 0.10 cent/l gje reflektuese me çmimin e berzës boterore, ndersa per muajin Dhjetor çmimi i berzes kishte renie dhe po ashtu çmimi importues/l ishte me i ulte se muajt paraprak, 0.88 cent/l, fitimi bruto/l per muajin Dhjetor ishte 0.29 cent/l, gje që ndermarrja Petrol Company ShPK nuk ka reflektuar me ulje te fitimit bruto/l karshi uljes se çmimit te berzes dhe çmimit importues. Ndërsa për produktin benzinë gjatë muajve Janar – Tetor 2018 ndermarrjet te cilat operone ne tregun perkates kane pas nje dallim te çmimit shites nga çmimi bleres mesatarisht rreth 12% fitimi bruto/l. Gjate muajit Nentor krahasuar me mesataren e muajve Janar - Tetor, çmimi bleres/l ka renie per 5.0% ndërsa çmimi shites/l krahasuar me periudhen e njejte është ritur per 7.0% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muaj Janar - Tetor eshte rritur per 108% ne raport me fitimin bruto/l per periudhen Janar - Tetor. Ndërsa, gjate muajit Dhjetor 2018 krahasuar me mesataren e muajve Janar – Tetor 2018, çmimi bleres/l ka renie per 12% ndersa çmimi shites/l ka rritje per 4% dhe mesatarja e fitimit bruto/l është rritur per 135% ne raport me periudhen e njejte. Nga faktet e konstatuara është vërtetuar se Petrol Company ShPK ka caktuar çmimin shites dhe marzhën e fitimit bruto per muajin Nëntor dhe Dhjetor ne menyre të bashkërenduar me kompanite/ndërmarrjet te cilat operojne ne tregun relevant, formë e bashkëpunimit, në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1.1 te Ligjit nr. 03/L-229 dhe plotësim ndryshimi i tij nr. 04/L-226, per Mbroitjen e Konkurrences.

65. Komisioni i Autoritetit Kosovar te Konkurrences ka konstatuar se kjo praktike është e bashkërenduar e rrjedhimisht e kualifikohet si marreveshje te heshtur (Tacit Collusion), dhe kjo ka ç'rregulluar konkurrencen tregtare gjate muajve Nentor e Dhjetor te vitit 2018, e qe me keto veprime ndermarja Petrol Company Sh.P.K ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 "Marreveshje te ndaluar apo praktike e bashkerenduar", paragrafi 1 nen paragrafi (1.1) te Ligjit per Mbrojtjen e Konkurrences Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare Nr. 88/25), dhe Ligji Nr. 04/L-226 per ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit Nr. 03/L-229 per Mbrojjen e Konkurrences.
66. Gjykata vlerëson se Ekspertiza e Ekspertit Financiar A.L. e dt. 08.03.2024 për çeshtjen e marzhes se fitimit dhe ate per tërë vitin kalendarik 2017 dhe 2018 nuk ka specifikuar marzhen e fitimit në raport me periudhën kontestuese prandaj nuk është me ndikim në konstatimin e gjendjes faktike për periudhën kontesuese.
67. Gjykata e vlerëson të pabazuara pretendimin e paditësit se vendimi është në kundërshtim me nenin 52 te Ligjit te Procedures se Pergjithshme Administrative, me arsyetim se dispozitivi eshte juridikisht i paqarte dhe ka kunderthenje ndermjet dispozitivit dhe arsyesimit. Ne piken 1 te dispozitivit nuk kuptohet se fare çka konstatuar e paditura ku thote se Petrol Company ka ç'rregulluar konkurrencen tregtare gjate muajve nentor dhe dhjetor të vitit 2018 e qe me këto veprime ka kryer shkelje te dispozitave te Ligjit per Mbrojtjen e Konkurrences nr. 03/I-229 neni 4 Marreveshje te ndaluara apo Praktike te bashkerenduar" pasi keto jane dy nocione te ndryshme. Gjykata vlerëson se sipas Ligjit NR. 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen E Konkurrencës Neni 2 1. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1., nën paragrafi 1.1. i riformuluar praktikat e bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve përkufizohen si një lloj koordinimi (marrëveshje jo formale) siç përcaktohet po aty: 1.1. **Marrëveshje** - marrëveshjet e çdo forme, të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, me ose pa forcë detyruese, vendimet ose rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve, **si dhe praktikat e bashkërenduara ndërmjet**

ndërmarrjeve, të cilat veprojnë në të njëjtin nivel, ose në nivele të ndryshme, të tregut. Kjo edhe në përputhje me interpretimin e GJED,²

68. **Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 4 (i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligji Nr. 04/L-226)** përcakton marrëveshjet e ndaluara, paragrafi 1 përcakton “Ndalohen të gjitha marrëveshjet ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura, vendimet e marrura ne mes te shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikave të bashkërenduar të cilat kanë për qëllim ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant e veçanërisht marrëveshjet që”: 1.1. caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi.

69. Eshtë i pabazuar pretendimi i paditësit se Vendimit i mungon arsyetimi i kuptueshëm në kuptim të nenit 48 të LPPA-së, vendimi nuk sqaron se mbi bazen e cilave prova ka nxjerr vendimin e atakuar, pasi që askund vendimi nuk përmban provat e provat e administruara, ngase e paditura në Njoftimi i fakteve paraprake të konstatuara në procedurë me nr.3370/19 i datës 21.11.2019, i ka listuar të gjitha provat në të cilat e ka bazuar analizën dhe vlerësimin e gjendjes faktike, dhe atë: të dhënat e mbeldhura gjate procedures hetimore per nderrmanjen “Petrol Company” ShPK Nr. Fiskal: 600118120. Autoriteti Kosovar i Konkurrences, Librin e blerjes nga 01.01.2018 deri më 31.12.2018, (fizike dhe ne forme elektronike), Librin e shitjeve nga 01.01.2018 deri më 31.12.2018, (fizike dhe në forme elektronike), Kontratat dhe aneks kontratat e tendereve te fituar prej 01.01.2018 deri me 31.12.2018, Qarkullimin vjetor te ofruar nga ATK - 01.01.2018 - 31.12.2018, Të gjitha importet nga Dogana me 01/01/2018 - 31/12/2018, Faturat e kerkuara nga Autoriteti, Procesverbali i datës 18.07.2019 i mbajtur me përfaqësues të PETROL COMPANY ShPK, Numrin e pikave të shitjes, të dhënat sasiore mbi shitjen me

² C-8/08, T-Mobile Netherlands BV (2009), par.26. për sa i përket përkufizimit të një praktike të bashkërenduar, Gjykata është shprehur se një praktikë e tillë, është një formë e koordinimit ndërmjet ndërmarrjeve me anë të së cilës, pa pa u arritur në një fazë që një marrëveshje siç duhet është arritur, bashkëpunimi praktik ndërmjet tyre është më vetëdijë është zëvendësuar rrezikun e konkurrencës (see Joined Cases 40/73 to 48/73, 50/73, 54/73 to 56/73, 111/73, 113/73 and 114/73 Suiker Unie and Others v Commission [1975] ECR 1663, paragraph 26, and Joined Cases C-89/85, C-104/85, C-114/85, C-116/85, C-117/85 and C-125/85 to C-129/85 Ahlström Osakeyhtiö and Others v Commission [1993] ECR I-1307, paragraph 63).

pakicë dhe shumicë për naftë dhe benzine, Kapacitetet e depove të derivateve të naftës, sasia e stoqeve.

70. Nga këto dokumente ka analizuar strukturën e tregut për secilin ndermarrje të cilat afrojnë në tregun e derivateve të naftës për periudhën 12 muajore të vitit 2018. Nga të cilat ka konstatuar se ndermarrjet të cilat operojnë në tregun relevant shitjes me pakicë të produkteve të naftës dhe benzine nuk kanë reflektuar në mënyrë individuale duke marrë për bazë çmimin e shitjes së fitimit bruto/l për muajin Nentor dhe Dhjetor për produktin benzinë kanë pasur fitimin bruto/l përfaqësisht 12% për muajt Janar - Tetor ndërsa për muajin Nentor, në mënyrë të bashkërenduar kanë realizuar fitimin bruto/l. Po ashtu sipas vendimit të kundërshtuar në par. 4 në bazë të të dhënave nga Dogana e Kosovës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka njerëz strukturën e tregut të ndermarrjeve të cilat importojnë dhe tregtojnë derivate të naftës me shumicë dhe pakicë.

71. Gjykata vlerësoj edhe pretendimin e paditësit “Petrol Company” çmimet e shitjes me pakicë kanë variuar nga një pikë e shitjes me pakicë tek pika tjetër me pakicë. Gjatë dhjetorit 2018 nga 0,99 euro e deri në 1,24 euro, ky dallim ky prej 15 cent në liter në mes të pikave të ndryshme të vetë paditëses, por vlerëson se një praktikë e tillë është në kundërshtim me strategjinë e ndermarrjes respektivisht arsyetimin se Marzhat e fitimit nga ana e Petrol Company gjatë periudhës kontestuese (Nentor Dhjetor 2018) kanë qenë reflektim i marzhave të ulta të fitimit që kompania ka realizuar në muajt paraprak dhe për këtë arsye, ka vendosur që në dy muajt e fundit të vitit të realizonte planin e vetë ekonomik për të arritur në mesataren e fitimit bruto për liter 0,10 euro. Për më tepër në gjykatë ka dorëzuar të dhënat në formë tabelare por këto të dhëna nuk janë të mbështetura me kupon fiskal, prandaj të njëjtave gjykata nuk ia falim besimin.

72. Po ashtu gjykata vlerëson se pretendimet se arsyetimi pos tjerash është edhe me formulime dhe kalkulime e tabela statistikore që janë për 14 kompani e nuk është arsyetim i individualizuar, janë të pabazuara. Sepse gjykata vlerëson se e paditura vlerësimin dhe konstatimin e ka bërë për secilën kompani, ashtu që në bazë të Dudit doganor të importit të produktit Naftë (2710194300) dhe Benzine (2710124500)

për ndermarrja Petrol Company Sh.p.k. ka kalkuluar sasin e litrave të importuara nga ka konstatuar se ndermarja PETROL COMPANY Shpk ka importuar 0.0 litra (nafte dhe benzinë) për të cilat importe nuk ka paguar akcize. Ndërsa gjatë vitit 2018 ka importuar 21,161,039.25 litra naftë dhe 3,574,239.40 litra benzine dhe që në total 24,735,278.65 litra derivate për vitin 2018. Po ashtu ka kalkuluar individualisht për secilën kompani pjesëmarrjen e përgjithshme në treg për Naftë dhe Benzine Petrol Company Shpk është 3.86%, vetëm për Naftë është 3.75%, vetëm për Benzine është 4.66%. Po ashtu ka kalkuluara çmimet individualisht dhe në krahasim me kompanit e tjerë në hetim ashtu që për paditësin ka konstatuar se nga analiza e të dhënave është konstatuar se për produktin naftë nga muaji Janar-Tetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ka qenë 0.09 cent/l ndërsa për muajin Janar-Tetor 2018 mesatarja e fitimit bruto/l ishte 0.18 cent/l. Në krahasueshmeri për muajin Shkurt dhe Dhjetor, muaji Shkurt 2018, çmimi blerës/l ishte 0.93 cent/l ndërsa fitimi bruto/l ishte 0.10 cent/l dhe çmimi shitës/l ishte 1.03 cent/l gjë që është reflektuese me çmimin e berzës botrore, ndërsa për muajin Dhjetor ku çmimi i berzës kishte rënie nga muaji paraprak dhe po ashtu çmimi importues/l ishte përfaqësues i njëjtit me muajin Shkurt 2018, 0.93 cent/l, fitimi bruto/l për muajin Dhjetor ishte 0.21 cent/l dhe çmimi shitës/l ishte 1.14 cent/l nga rezulton se ndermarrja Petrol Company ShPK nuk ka reflektuar me ulje të fitimit bruto/l karshi uljes së çmimit të berzës dhe çmimit importues.

73. Forma e caktimit të çmimit apo marzha e fitimit duke aplikuar praktike të bashkërenduar nga ndermarjet të cilat operojnë në tregun relevant është në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-229 dhe plotësim ndryshimi i tij nr. 04/L-226, për Mbrojtjen e Konkurrencës, ku theksohet se: cakton, në mënyrë të dretpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi. Mbi këto baze ligjore dhe faktet e konstatuara, Autoriteti Kosovari i Konkurrencës, ka konstatuar se e ndermarrja Petrol Company ShPK ka caktuar çmimin shitjes dhe marzhën e fitimit bruto/l për muajin Nëntor dhe Dhjetor në mënyrë të bashkërenduar me kompanitë/ndermarjet tjera të cilat operojnë në tregun relevant, në shitje me pakicë, forme e bashkepunimit e cila sanksionohet me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

74. Po ashtu, Autoriteti Kosovar i Konkurrences i ka vlerësuar çmimet ndermarrjet te cilat operojne ne tregun perkatës për produktin naftë, ka vlerësuar se gjatë muajve Janar - Tetor kane pas nje dallim te çmimit shites nga çmimi bleres mesatarisht rreth 9% fitimi bruto/l. Ndërsa gjate muajit Nëntor krahasuar me mesataren e muajve Janar - Tetor, çmimi bleres/l ka ritje per 2.0% ndersa çmimi shites/l krahasuar me muajt, eshte ritur per 7% dhe mesatarja e fitimit bruto/l eshte rritur per 60% ne raport me fitimin bruto/l per periudhën Janar - Tetor. Ndërsa gjate muajit Dhjetor krahasuar me mesataren e muajve Janar Tetor, çmimi bleres/l ka renie per 8% ndersa çmimi shites/l ka ritje per 4% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muajit Janar - Tetor eshte ritur per 124% ne raport me periudhen e njejte.
75. Ndërsa për produktin benzinë gjatë muajve Janar – Tetor 2018 ndermarjet te cilat operojne ne tregun perkates kane pas nje dallim te çmimit shites nga çmimi bleres mesatarisht rreth 12% fitimi bruto/l. Gjate muajit Nentor krahasuar me mesataren e muajve Janar - Tetor, çmimi bleres/l ka renie per 5.0% ndërsa çmimi shites/l krahasuar me periudhen e njejte është ritur per 7.0% dhe mesatarja e fitimit bruto/l krahasuar me muaj Janar - Tetor eshte rritur per 108% ne raport me fitimin bruto/l per periudhen Janar - Tetor. Ndërsa, gjate muajit Dhjetor 2018 krahasuar me mesataren e muajve Janar – Tetor 2018, çmimi bleres/l ka renie per 12% ndersa çmimi shites/l ka rritje per 4% dhe mesatarja e fitimit bruto/l është rritur per 135% ne raport me periudhen e njejte.
76. Ndërsa mesatarja e fitimit bruto/l e paditësit për produktin benzin nga muaji Janar-Tetor 2018 ka qene 0.12 cent/l, ndersa per muajin Janar-Tetor 2018 mesatarja fitimi bruto/l ishte 0.28 cent/l. Në krahasim me muajin Shkurt dhe Dhjetor 2018, në Shkurt çmimi bleres/l ishte 0.95 cent/l ndersa fitimi bruto/l ishte 0.10 cent/l gje reflektuese me çmimin e berzës boterore, ndersa per muajin Dhjetor çmimi i berzes kishte renie dhe po ashtu çmimi importues/l ishte me i ulte se muajt paraprak, 0.88 cent/l, fitimi bruto/l per muajin Dhjetor ishte 0.29 cent/l, gje që ndermarrja Petrol Company ShPK nuk ka reflektuar me ulje te fitimit bruto/l karshi uljes se çmimit te berzes dhe çmimit importues.
77. Nga këto fakte ka konstatuar se paditësi “Petrol Company” ShPK ka caktuar çmimin shites dhe marzhën e fitimit bruto per muajin Nëntor dhe Dhjetor ne menyre

të bashkërenduar me kompanite/ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun relevant, formë e bashkëpunimit, në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-229 dhe plotësim ndryshimi i tij nr. 04/L-226, për Mbrojtjen e Konkurrencës.

78. Komisioni i Autoritetit Kosovë të Konkurrencës konstaton se kjo praktikë është e bashkërenduar e rrjedhimisht e kualifikohet si marrëveshje e heshtur (Tacit Collusion), dhe kjo ka ç'rregulluar konkurrencën tregtare gjatë muajve Nëntor e Dhjetor të vitit 2018, e që me këto veprime ndërmarrja Petrol Company Sh.P.K ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 "Marrëveshje të ndaluar apo praktikë e bashkërenduar", paragrafi 1 nën paragrafi (1.1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare Nr. 88/25), dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.
79. Gjykata vlerëson se për të ardhur të konstatimi se ndërmarrjet janë të përfshira në praktikën të përbashkët duhet të merren parasysh faktorëve të ndryshëm siç janë: *Sjellja paralele e konkurrentëve në një industri të caktuar* që shfaqet me strategji të ngjashme tarifore, sjellje të tregut, apo praktika biznesi pa një shpjegim të arsyeshëm, mund të tregojë bashkëpunim ose veprim të përbashkët, *shkëmbimi i informacionit midis konkurrentëve në lidhje me çmimin, produktin, apo çështje të tjera të biznesit*, që mund të përfshijë komunikimin e drejtpërdrejtë, apo edhe shkëmbimet e tërthorta nëpërmjet palëve të treta, *Struktura e tregut gjeografik* - tregu i përqëndruar mund të ofrojë mundësi për bashkëpunim për shkak të presionit të reduktuar konkurrues, *Analiza ekonomike* që mund të përfshijë ndryshimin e çmimeve, profitabilitetin dhe faktorë të tjerë relevantë për të vlerësuar nëse veprimet janë është në përputhje me sjelljen konkurruese apo tregon bashkëpunim.
80. Në Bashkimin Evropian, përcaktimi i praktikave të përbashkëta përfshin një analizë të sjelljes midis bizneseve që edhe pse nuk arrijnë në mënyrë eksplicite një marrëveshje për të rregulluar çmimet apo për të kufizuar prodhimin, ende koordinojnë veprimet e tyre në një mënyrë që reduktojnë apo ç'rregullojnë konkurrencën, marrëveshje/praktika këto të ndaluara me Nenin 101 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU).

81. Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GjED) ka vendosur se edhe nëse nuk ka marrëveshje detyruese, shkëmbimi i informacionit madje edhe mundësia e shkëmbimit të informacionit mund të përbëjë një praktikë të përbashkët nëse ndikon në sjelljen e sipërmarrjeve pjesëmarrëse duke reduktuar sigurinë strategjike në treg.³ Lidhur me këtë konstatim gjykata vlerëson se nga provat e administruara në procesverbal të seancës degjimore pronari “Petrol Company” SH.P.K., kishte deklaruar se” çmimeve paralele, une theksova se çmimet mund të jene shume te ngjashme per arsye te furnizimit te taksave dhe te gjitha shpenzimeve të barabarta ose te peraferta qe i kemi. Ndersa sa i perket percaktimit te çmimeve ne bazë te konkurrencës ka mundesi qe stafi jone mos ta kete pas mundesin ose dijenine e duhur per me interpretar mjaftueshem qarte, per shkak se nese klientet e caktuar vine te ne dhe deklarojnë se diku jeter e kane gjete derivatin me nje çmim me te lire, por po donë me ble tek ne, ne në ato momente i ofrojme çmimet me zbritje, çka rezulton se mundësia për të pasur komunikim në mes të palëve të treta është reale dhe e zakonshme.⁴

82. Po ashtu Gjykata vlerëson se krijimi i praktikave të bashkërenduara për konkurrencën nuk varet nga një kohëzgjatje specifike, sepse praktikat e bashkërenduara përcaktohen bazuar në thelbin e veprimeve të ndërmarrja nga kompanitë e përfshira dhe ndikimin e tyre në konkurrencën në treg. Praktikrat e përbashkëta mund të përfshijnë forma të ndryshme të koordinimit ose bashkëpunimit midis konkurrentëve si fiksimi i çmimeve, kufizimet e prodhimit, shkëmbimi i informacionit etj, që mund të ndodhin për një periudhë të shkurtër ose për një periudhë të zgjatur kohore, në varësi të rrethanave të rastit. GjED sqaroi se rast i vetëm i shkëmbimit të informacionit midis konkurrentëve mund të përbëjë një

³ GjED në rastin 48/69, *ICI v Commission* (Dyestuffs Case), 1972 theksoi që praktikrat e bashkërenduara nuk kërkojnë një marrëveshje formale mes ndërmarrjeve për të qenë të paligjshme. Duke zgjeruar kështu kuptimin e bashkëpunimit të ndaluar midis konkurrentëve konkurrentet e tyre veprojnë bashkërisht në treg duke përfshirë çdo formë të koordinimit që zëvendëson konkurrencën me veprime të njohura të përbashkëta. Në këtë rast, GjED vëmendje të veçantë i kushtoi mënyrës nga provat u vërtetua se vendimet e njëkohshme për ngritjen e çmimeve, së bashku me mundësinë e takimeve mes konkurrentëve përbënin prova të mjaftueshme për të mbështetur përfundimin se kishte praktika të bashkërenduara.

⁴ C-74/14, *Euras dhe të tjerë* (2016) GjED vendosi se thjesht marrja e një mesazhi që synonte koordinimin e sjelljes së tregut mund të ishte e mjaftueshme për të vendosur pjesëmarrjen në një praktikë të përbashkët.

praktikë të përbashkët nëse ka për qëllim të ndikoj në sjelljen e tregut ose nëse pjesëmarrësit më pas silleshin në treg sikur të ishin në dijeni të sjelljes së ardhshme të njëri-tjetrit.⁵

83. Gjykata vlerëson se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun relevant shitjes me pakicë të produkteve të naftës dhe benzine përfshirë këtu edhe paditësin janë përfshirë në praktika të përbashkëta pa marrëveshje eksplicite gjatë muajit nëntor dhe dhjetor të vitit 2018, me një paralelizëm të ndërgjegjshëm, në kundërshtim Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 4 (i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligji Nr. 04/L-226) përcakton marrëveshjet e ndaluara, paragrafi 1 përcakton “Ndalohen të gjitha marrëveshjet ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura, vendimet e marrura në mes të shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikave të bashkërenduar të cilat kanë për qëllim ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant e veçanërisht marrëveshjet që”: 1.1. caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi.
84. Neni 56 i Ligjit bazik përcakton Masat Ndëshkuese për Shkelje të Rënda të Rregullave në Konkurrencën e Tregut paragrafi 1 parasheh se “Masa ndëshkuese në një shumë deri në dhjetë për qind (10%) të totalit të të hyrave që ndërmarrja e ka realizuar në vitin e fundit për të cilin është përfunduar raporti financiar, ndëshkohet ndërmarrja nëse”: 1.1. lidhë marrëveshje të ndaluara ose në ndonjë mënyrë tjetër merr pjesë në marrëveshjen me të cilën është çrregulluar konkurrenca, në mënyrën e përshkruar në dispozitën e nenit 4 të këtij ligji; 1.2. abuzon me pozitën dominuese të përcaktuar në nenin 11 të këtij ligji; 27 1.3. merr pjesë në zbatimin e përqendrimeve të ndaluara të ndërmarrjeve, të përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji; 1.4. nuk vepron në pajtim me vendimin e Autoritetit me të cilin përcaktohen masat për rivendosjen e konkurrencës ose përcaktohen masat e përkohshme sipas nenit 54

⁵ Rasti C-8/08, T-Mobile Netherlands BV (2009) paragrafi 60. numri, shpeshësia dhe forma e takimeve ndërmjet konkurrentëve që nevojiten për të harmonizuar sjelljen e tyre në treg varen si nga objekti i atij veprimi të bashkërenduar dhe kushtet e veçanta të tregut. Nëse ndërmarrjet në fjalë krijojnë një kartel me një sistem kompleks veprimesh të bashkërenduara në lidhje me një sërë aspektesh të sjelljes së tyre në treg, mund të nevojiten takime të rregullta për një periudhë të gjatë. Nëse, nga ana tjetër, si në procedurën kryesore, objektivi i ushtrimit është vetëm të bashkërendojë veprimin mbi baza selektive në lidhje me një ndryshim të njehershëm në sjelljen e tregut duke iu referuar thjesht një parametri të konkurrencës, një takim i vetëm ndërmjet konkurrentëve mund të përbëjë një bazë të mjaftueshme për të zbatuar objektivin antikonkurrenues që synojnë të arrijnë ndërmarrjet pjesëmarrëse.

paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1 deri në nën-paragrafin 1.7 të këtij ligji, Neni 59 përcakton Kriteret për Shqiptimin e Masave Ndëshkuese paragrafi 1 parasheh se “Shuma më e lartë e masës ndëshkuese që mund të shqiptohet në bazë të këtij ligji në asnjë rast nuk duhet të tejkaloj shumën prej dhjetë përqind (10%) të totalit të të hyrave që ndërmarrja i ka realizuar në tri (3) vitet e fundit për të cilin është përfunduar raporti financiar, sipas nenit 56 të këtij ligji” paragrafi 2 parasheh se “ Me rastin e shqiptimit të masës ndëshkuese Autoriteti i merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese sipas peshës së shkeljes së veprës, sipas këtij ligji, kohëzgjatjes së shkeljes dhe pasojat e shkeljes për ndërmarrjet tjera në treg si dhe konsumatorët. Në këtë rast përdoret procedura e dyshkallëshe e përlllogaritjes së masës ndëshkuese administrativ në atë mënyrë që cakton bazën e shumës së masës për ndërmarrjen, atëherë shuma e përcaktuar zvogëlohet ose rritet në varësi të rrethanave lehtësuese ose rënduese”, paragrafi 4 parasheh Rrethana lehtësuese të përcaktuara në paragrafin 2 . të këtij neni konsiderohen: 4.1. njoftimi i ndërmarrjeve për fillimin e procedurës nga Autoriteti, urgjentisht i dorëzon provat për ndërprerjen e veprimit të kundërligjshëm. Përrjashtimisht, në rastin e karteleve dorëzimi i provave për ndërprerjen e veprimit të kundërligjshëm nuk do të konsiderohet si rrethanë lehtësuese; 4.2. dorëzimi i të dhënave për shkeljen e këtij ligji si shkak i pakujdesisë së ndërmarrjes; 28 4.3. dorëzimi i të dhënave që ndërmarrja edhe pse është pjesëmarrës i një marrëveshje të ndaluar, nuk e ka zbatuar atë marrëveshje, respektivisht edhe pse ka ekzistuar marrëveshja, ka vepruar në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e konkurrencës; 4.4. bashkëpunimi i ndërmarrjes me Autoritetin i cili i tejkalon detyrimet e ndërmarrjes për lirim ose zvogëlimin e masave ndëshkimore administrative, bazuar në këtë nen.

85. Prandaj, Gjykata vlerëson se gjopa e shqiptuar është në përputhje me Udhezimin Administrative nr.01/2018 mbi kriteret për shiptimin e masës së sanksioneve administrative neni 3, 4 dhe neni 8, Komisioni i Autoritetit Kosovar e Konkurrencës kalkulimin e sanksionit administrative e ka bërë në këtë mënyrë: Rasti i derivateve është për vitin 2018, ndërsa shkelja është konstatuar për muajt Nentor dhe Dhjetor 2018. Tregu relevant janë derivatet e natës, ndërsa zona gjeografike është territori i Kosovës. Në rast seperiudha e shkeljes së këtij ligji është më e shkurtër se 6 (gjashtë) muajt, Autoriteti e konsideron si gjysëm e vitit dhe ndëshkimi aplikohet në

qarkullimin per periudhen Korrik – Dhjetor 2018, në perputhje me neni 4 par. 4 te UA. Prandaj për qarkullimi per 6 muaj te vitit 2018 per ndermarren PETROL COMPANY Shpk ishte: €7,533,697.37, Te hyrat bruto per 6 muaj: €7,533,697.37, TVSH e perlllogaritur (TVSH = Norma × 100 / Norma + 100) = 15.254%. TVSH €7,533,697.37 x 15,254% = € 1,149,190.20, Baza per aplikimin e Ndeshkimit (BN) = Te hyrat Bruto - TVSH €7,533,697.37, €1,149,190.20= € 6,384,507.17), te hyrat Neto: € 6,384,507.17. Baza e ndëshkimit Gjykata gjeti se një rast i vetëm i shkëmbimit të informacionit në një mbledhje përbënte një praktikë të përbashkët është € 6,384,507.17, duke aplikuar normen 3% ne bazën e ndëshkimit € 6,384,507.17 (€ 6,384,507.17 × 3%) = € 191,535.22

86. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.361/22, datë 15.04.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.